

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BALFIN REAL ESTATE & HOSPITALITY SH.P.K
RRUGA DERVISH HIMA, PALLATI AMBASADOR 3,
KATI 21, AP. 163, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TIRANË, SHQIPËRI
NUI: L81507052H

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 29.03.2021, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **BALFIN REAL ESTATE & HOSPITALITY** sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L81507052H (më tej referuar si "Shoqëria"), me adresë Rruga "Dervish Hima", Pallati "Ambasador 3", kati 21, Ap. 163, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, Shqipëri, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Balkan Finance Investment Group Sh.p.k** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 025864525, - zotëruese e 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj, (**referuar edhe si: Ortaku i Vetëm**);

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit të mbledhjes.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. ZMADHIMI E KAPITALIT TË SHOQËRISË;
- II. TE NDRYSHME

Duke kaluar në diskutimin e çështjes në të Rendit të Ditës, Kryetari parashtrohet se për nevojën të Shoqërisë për investime që do të kryejë, kërkohet financimi i saj me një shumë prej 100,000 EUR (njëqind mijë euro), Financimi do të jepet në formën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë, i cili nga 112,110,000 LEK (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e dhjetë mijë lekë), do të zmadhohet në 100,000 EUR (njëqind mijë euro) ose kundërvlerën e Leke sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 29.03.2021 (1 Euro = 123.27), për një rritje kapitali në shumën 12,327,000 Leke (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzetë e shtete mijë lekë) duke e çuar kapitalin në një vlerë totale prej 124,437,000 Leke (njëqind e njëzetë e katër milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI



- A. TË MIRATOJË ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË **BALFIN REAL ESTATE & HOSPITALITY SH.P.K.**, (NUIS: L81507052H) ME 12,327,000 LEK (DYMBËDHJETË MILION E TREQIND E NJËZETË E SHTETE MIJE LEKË) ("ZMADHIMI I KAPITALIT");
- B. ZMADHIMI I KAPITALIT DO TË NËNSHKRUHET DHE SHLYHET TËRËSISHT NGA ORTAKU I VETËM NË PARA.
- C. KAPITALI I SHOQËRISË PAS ZMADHIMIT NGA 112,110,000 LEK (NJËQIND E DYMBËDHJETË MILION E NJËQIND E DHJETE MIJE LEKË) DO TË BËHET 124,437,000 LEK (NJËQIND E NJËZETË E KATËR MILION E KATËRQIND E TRIDHJETË E SHTATE MIJE LEKË).
- D. TË AUTORIZOJË PËRDORIMIN E KAPITALIT TË INJEKTUAR PËR INVESTIME TË PARASHIKUARA NGA SHOQËRIA.
- E. TË AUTORIZOJË ADMINISTRATORIN NË DETYRË TË SHOQËRISË, PËR TË KRYER TË GJITHA APLIKIMET E NEVOJSHME ME QËLLIM REGJISTRIMIN E KËTIJ VENDIMI PRANË QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT, PERSONALISHT OSE NËPËRMJET AUTORIZIMIT TË PERSONAVE TË TJERË PËR KËTË QËLLIM.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Balfin Real Estate" SHPK mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

* * * *

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
BALFIN REAL ESTATE & HOSPITALITY SH.P.K**

ORTAK I VETËM
BALFIN SH.P.K

Znj. Edlira MUKA



Sekretari

Z. Bers Hado

Z. Bers Hado